



Das Jugendbüro (zyra për të rinjtë) mbulon punën me fëmijët dhe të rinjtë në Crailsheim. **Këtu përfshihen** puna sociale në shkollë, puna e hapur me të rinjtë, puna mobile (në lëvizje) me të rinjtë si edhe aktivitetet gjatë pushimeve. Me fokus në fusha të larmishme, zyra për të rinjtë u ofron fëmijëve dhe të rinjve mbështetje të orientuar sipas nevojave të tyre, këshillim dhe mbështetje në të gjitha çështjet specifike për të rinjtë. Nëpërmjet punës së tij, ekipi i Jugendbüro, synon të nxisë të rinjtë në zhvillimin e tyre personal dhe shoqëror si edhe t'u japë impulse për të ndihmuar në formimin e jetës së tyre.

Puna sociale në shkollë

Qëllimi i punës sociale në shkollë është këshillimi social pedagogjik, orientimi dhe mbështetja e nxënësve, mësuesve, drejtuesve të shkollave dhe prindërve si edhe të ofrimi i shërbimeve individuale për grupet, për klasat dhe shërbime parandaluese. Puna sociale në shkollë është një shërbim vullnetar, në nivel të ulët që i nënshtrohet konfidencialitetit dhe përbën një pjesë të rëndësishme të komunitetit shkollor. Në Crailsheim, çdo shkollë publike është e pajisur me punë sociale.

Puna e hapur me të rinjtë

Në Crailsheim, puna e hapur me fëmijët dhe të rinjtë, vihet në jetë në ambiente të ndryshme rinore, në pjesë të ndryshme të qytetit. Ambientet janë vende të hapura takimi, që u ofrojnë rinjve mundësinë të zhvillohen dhe të shpalosin prirjet e tyre në kohën e lirë. Persona të besuar kontakti ofrojnë mbështetje dhe mundësojnë gjithashtu marrjen e ndihmës së duhur. Kështu, përmes ofertave individuale, të cilat janë të përshtatura me situatat e jetës dhe nevojat e të rinjve, bëhet shoqërimi i të rinjve drejt rritjes. Për të rinjtë, takimet në ambientet rinore janë një plotësues i rëndësishëm për shkollën dhe familjen.

Puna mobile (në lëvizje) me të rinjtë

Shërbimet e punës mobile me të rinjtë variojnë që nga bisedat individuale, tek gjetja e trajnimeve profesionale apo punësimit e deri tek organizimi i aktiviteteve të kohës së lirë. Përmes punës në rrugë (Streetwork) vendosen dhe thellohen kontaktet, gjithnjë duke pasur në fokus të rinjtë që ndodhen në situata të vështira të jetës së tyre.

Në konsultimet individuale, **çështjet** e tyre merren seriozisht dhe bashkërisht zhvillohen ide për zgjidhjen e tyre. Projektet individuale dhe ofertat e grupit, ofrojnë mundësinë për të përjetuar së bashku aktivitetet e organizuara në kohës së lirë.

Argëtimi në kohën e lirë dhe në pushime

Bashkia e Crailsheim u mundëson të gjithë fëmijëve dhe të rinjve të përjetojnë një shumëllojshmëri veprimtarish gjatë pushimeve. Punonjësit e Jugendbüro, të punës sociale në shkollë, të punës së hapur me të rinjtë dhe të punës mobile me të rinjtë, organizojnë së bashku aktivitetet për fëmijë dhe të rinjtë, të cilat janë të pasura me oferta të tjera, të partnerëve tanë të shumtë bashkëpunëtorë. Këtu bëjnë pjesë si veprimtaritë e rregullta gjatë gjithë vitit, po ashtu edhe programet e larmishme me aktivitete të reja, informacionet për të cilat janë të disponueshme në internet në lidhjen www.jugendbuero-crailsheim.feripro.de. Krahas ofertave më të mëdha gjatë pushimeve, ambientet rinore janë të hapura edhe gjatë pushimeve shkollore dhe ofrojnë veprimtari me gamë më të ulët.

Informacionet aktuale, të dhënat e kontaktit të punonjësve dhe të lokacioneve të zyrës së Jugendbüro do t'i gjeni në faqen e mëposhtme: <https://www.jugendbuero-crailsheim.de/>

Mbështetje financiare për familjet

Jo të gjithë prindërit janë të vetëdijshëm për mundësitë e financimit, të cilat ofrojnë mbështetje financiare për familjet. Ne dëshirojmë t'ju informojmë dhe njëkohësisht të kontribuojmë që asnjë fëmijë të mos mbetet pas.

A ofrohet Wohngeld (subvencionim për banesën)?

Subvencionimi i banesës, është një ndihmë shtetërore për shpenzimet banesës vetjake. Qëllimi i subvencionimit të strehimit është, të ndihmojë familjet për të përballuar shpenzimet për banimin dhe t'u mundësojë atyre të banojnë në mënyrë adekuate dhe të përshtatshme për familjen. Subvencionimi i banesës mund t'u jepet qiramarrësve si një "ndihmë për qiranë" edhe pronarëve të shtëpive që i përdorin vet shtëpitë apo apartamentit mund të marrin një "kompensim për barrën".

Kë mund të kontaktoj?

Rathaus Crailsheim – Wohngeldstelle -07951-403-1211 – wohngeld@crailsheim.de

Çfarë është Kinderzuschlag (suplementi për fëmijët)?

Suplementi për fëmijët, është një mbështetje e sigurt për familjet me të ardhura të vogla, e cila vepron si një shtesë në paratë e fëmijës (Kindergeld). Nëse një familje merr Kinderzuschlag për fëmijën, kjo varet nga rasti individual. Kjo varet në veçanti nga numri i fëmijëve, mosha e tyre dhe kostoja e strehimit.

Kë mund të kontaktoj?

Familienkasse BaWü – 0800 4 555530 (falas) – www.kinderzuschlag.de

Kush e përfiton Bildungspaket (paketën për arsimin)?

Fëmijët dhe të rinjtë kanë nevojë për mundësi të mira në arsim dhe në pjesëmarrje. Kjo vlen veçanërisht, kur burimet financiare të familjes janë të pakta.

Bildungspaket u mundëson këtyre fëmijëve të marrin pjesë në klubin sportiv, shkollën e muzikës apo të përfitojnë nga ofertat e pushimeve. Përveç kësaj, ofrohet mbështetje sipas nevojave personale të shkollimit, për nxitjen e të mësuarit dhe udhëtimet shkollore.

Për fillimin në vitin e ri shkollor, ekziston Schulstarterpaket (paketa fillestare), me të cilën prindërit nuk kanë nevojë të paguajnë pjesën e tyre për drekën në Kita dhe në shkollë, si dhe as për transportin e nxënësve dhe përkrahja individuale për nxitjen e të m, mund të kërkohet nga të gjithë.

Ku mund të kontaktoj?

Jobcenter Landkreis Schwäbisch Hall - Crailsheim – 07951-9490-583

Mos kini druajtje! Ne rekomandojmë që, në rast se jeni të pasigurt, ta bëni gjithsesi aplikimin, sepse shpesh mundësitë nënvlerësohen. Të gjitha përfitimet e marra, nuk rikthehen!